

ANALIZA VJETORE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

MBI ECURINË E AKTIVITETEVE PËR VITIN 2021





Analiza vjetore e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive

mbi ecurinë e aktiviteteve
për vitin 2021

Bulevardi "Bajram Curri", Tiranë
www.akpa.gov.al
Shkurt, 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

SKEDA PREZANTUESE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.....	6
--	---

KAPITULLI I

DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2021	8
Politika e Punësimit në Shifra.....	9
Shifrat e Papunësisë së regjistruar në Zyrat e Punësimit.....	9
Vendet e lira të punës të shpallura në Zyrat e Punës	10
Programet e Nxitjes së Punësimit.....	11
Programet e Formimit Profesional Publik	15
Pagesa e Papunësisë	16
Shtetasit e huaj të punësuar në Shqipëri	17

KAPITULLI II

PUNËSIMI I DENJË NËPËRMJET SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT DHE

POLITIKAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS.....	18
Modernizimi i Shërbimit Publik të Punësimit	19
Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë në AKPA	18
Përminësimi funksional i strukturave të ofrimit të shërbimeve të punësimit.....	20
Diversifikimi i Programeve Aktive të Tregut të Punës	21
Përminësimi i procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit	22
Fuqizimi i Dialogut Social	23

KAPITULLI III

OFRIMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR	24
Optimizimi i Ofruesve të AFP-së	25
Infrastruktura, investimet në Ofruesit Publik të AFP-së	25
Diversifikimi i Ofertës në AFP në Përputhje me Nevojat e Tregut të Punës	26
Përminësimi dhe zbatimi i procedurave të licencimit dhe monitorimit të ofruesve privatë të AFP-së.....	27

KAPITULLI IV

PËRFSHIRJA SOCIALE DHE KOHEZIONI TERRITORIAL	28
Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara	29
Zbatimi i parimit të Përfshirjes Sociale në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe Formimit.....	29
Fusha e punësimit.....	29
Fusha e Ansimit dhe Formimit Profesional.....	30

KAPITULLI V

FORCIMI I MARRËDHËNIEVE DHE BASHKËPUNIMIT ME PUNËDHËNËSIN	31
Ngritja e Bordeve të Bashkëpunimit Rajonal	32
Analiza Rajonale e Tregut të Punës	33
Fondi Social.....	33

KAPITULLI VI

ZBATIMI I KORNIZËS SË MONITORIMIT DHE MATJES

SË PERFORMANCËS	34
Planifikimi dhe instrumentet e monitorimit të brendshëm institucional.....	35
Karta e Performancës	35
Gjurmimi i të certifikuarve dhe diplomuarve të AFP-së	35
Ngritja e sistemit të monitorimit të ofruesve të Ansimit dhe Formimit Profesional	36

KAPITULLI VII

TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN	37
Strategjia e Komunikimit	38
Panairi i Punës.....	38
Publikimi i Vendeve të Lira të Punës.....	38
Rastet e suksesit, promovimi i tyre dhe përgatitja e materialeve të tjera promovuese	38
Menaxhimi i Sistemit të Kërkesave për Informacion dhe i Ankesave në AKPA	39

KAPITULLI VII

LIDHJET ME PROJEKTE, PROGRAME DHE PARTNERË STRATEGJIKË	43
--	----

SKEDA PREZANTUESE E AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA) është një institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive, e cila është krijuar dhe ushtron veprimtarinë administrative në bazë të Ligjit nr. 15/2019, "Për Nxitjen e Punësimit", Ligjit Nr. 15/2017, "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë", si dhe Vendimit Nr. 554, datë 31.07.2019 "Për Krijimin, Mënyrën e Organizimit dhe të Funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive". Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është institucion publik, i cili ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me:

Ligjin Nr. 15/2019, „Për nxitjen e punësimit“,
Ligjin Nr.152/2013 "Për Nëpunësin Civil"
Ligjin Nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar,
VKM Nr. 554, datë 31.7.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive";
Urdhrit e Kryeministrit Nr. 172 datë 24.12.2019 "Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive".

Misioni i AKPA-së është të sigurojë përmbushjen e të drejtës së shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi të huaj, që kanë përfituar statusin e refugjatit si dhe të azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t'u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

Objektivat e AKPA-së përcaktohen përmes dokumentit të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022, ku përkatësisht institucioni angazhohet në përmbushjen e 4 prioritetëve kryesorë:

- A- Nxitja e mundësive për punë të denjë nëpërmjet politikave aktive të tregut të punës;**
- B- Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit;**
- C- Promovimi i përfshirjes sociale dhe i kohezionit territorial;**
- D- Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemit të kualifikimeve profesionale.**

Në rrafshin institucional, AKPA ka këto përgjegjësi funksionale:

- Të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit;
- Të organizojë punën për administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e pasive të tregut të punës;
- Të organizojë punën për administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;
- Të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e drejtorive rajonale, të zyrave vendore dhe të ofruesve publikë të arsimit profesional;
- Të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Organizimi institucional- Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive është tërësia e institucioneve administrative dhe ofruese të shërbimeve të punësimit, të vetëpunësimit dhe të arsimit e formimit profesional, pjesë integrale e sistemit të ministrisë përgjegjëse për punësimin dhe zhvillimin e aftësive. AKPA shtrin veprimtarinë e saj në të gjithë terri-

torin e Republikës së Shqipërisë. Ajo organizohet:

- në nivel qendror, nëpërmjet drejtorisë qendrore;
- në nivel rajonal, nëpërmjet drejtorive rajonale;
- në nivel vendor, nëpërmjet zyrave vendore.

Skema e Organizimit institucional:

- Drejtoria Qendrore
- 12 Drejtori Rajonale Punësimi
- 40 Zyra Vendore Punësimi
- 10 Drejtori Rajonale të Formimit Profesional Publik
- 34 Shkolla Profesionale

Buxhetit total 2021:

2,428,600,000 ALL





KAPITULLI I

DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2021

Konteksti ekonomik dhe social

Sipas të dhënave të Anketës së Forcës së Punës në 3 mujorin e IV 2021 për popullsinë 15-64 vjeç:

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është 70.4 %. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020, shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës është rritur me 1.7 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm të vitit 2021 ky tregues ka pësuar një rritje prej 0.3 pikë përqindje.

Shkalla e punësimit është 62.1%. Gjatë këtij tremujori, në terma vjetorë punësimi shfaqi një tendencë rritje krahasuar me të njëjtin tremujor të vitit 2020, prej 2.1%. Në terma tremujorë, krahasuar me tremujorin e tretë të vitit 2021, punësimi pësoi një rritje prej 0.1 pikë përqindje.


Shkalla zyrtare e papunësisë është 11.4%. Krahasuar me tremujorin e katërt të vitit 2020, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rënie prej 1.9 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e tretë 2021, shkalla zyrtare e papunësisë pësoi një rritje prej 1.0 pikë përqindje.

DINAMIKAT E TREGUT TË PUNËS PËR VITIN 2021


Politika e Punësimit në Shifra

Seksioni i mëposhtëm paraqet një analizë përshkruese të të dhënave statistikore që pasqyrojnë rezultatet kryesore të aktivitetit të Zyrave të Punës për periudhën Janar - Dhjetor 2021.

Shifrat e Papunësisë së regjistruar në Zyrat e Punësimit



Gjatë vitit 2021 numri mesatar i pu.pa-ve të regjistruar në Zyrat e Punës, ishte 87,419 individë. Vihet re se, një pjesë e konsiderueshme e regjistrimit të Pu.Pa-ve përbëhet nga persona të cilët përfshihen në një ose më shumë grupe të veçanta.



Duke e analizuar regjistrin e pu.pa-ve sipas moshës dhe arsimit, vihet re se rreth 47% e totalit të pu.pa-ve janë mbi 45 vjeç dhe 56% me arsim deri në 9 vjeçar, çka e vështirëson integrimin e këtyre pu.pa-ve në tregun e punës. Kjo tendencë është me e theksuar në grupet e veçanta.

Punëkërkuessit e papunë të regjistruar sipas arsimit

Totali	Më pak se fillor	Fillor	9 vjeçar	Mesme përgj.	Mesme prof.	Universitare
87,419	2,941	3,270	42,542	24,043	6,791	7,833

Punëkërkuessit e papunë të regjistruar sipas grupmoshës

Totali	15 - 19	20 - 24	25 - 29	30 - 34	35 - 39	40 - 44	45 - 50	mbi 50
87,419	2,357	8,991	8,808	8,337	8,627	9,128	11,038	30,133


Në dallim nga të gjithë kategoritë e tjera, kategoria romë/ egjiptianë karakterizohet nga një moshë relativisht e re dhe një mungesë të theksuar arsimimi. Këto karakteristika e rrisin vështirësinë e integritit të këtij grupi në tregun e punës, pasi përbën problem edhe për dërgimin e kësaj kategorie në kurse formimi profesional.

Vendet e lira të punës të shpallura në Zyrat e Punës

Për përcaktimin e treguesve të monitorueshëm për vitin 2021, AKPA mori në konsideratë pasojat e krijuara nga pandemia e COVID-19, sidomos për treguesit të cilët lidheshin me regjistrimin e subjekteve të reja, shpalljen e VLP-ve dhe punësimin. Gjatë vitit 2021 u shpallën 24,965 vende të lira pune duke realizuar 98% të objektivit vjetor. Sipas aktiviteteve ekonomike numri më i lartë i vendeve të lira është marrë nga industria përpunuese (48%), ndërtim (10%) dhe akomodimi dhe shërbimi ushqimor (9%).

Aktivitetet ekonomike	VLP të shpallura (%)
Industria Përpunuese (a+b+c+d)	48
(Përpunimi i produkteve ushqimore, pijeve dhe produkteve të duhanit)	8
(Përpunimi i tekstileve, konfeksionimi i veshjeve dhe prodhimi i lëkurës dhe produkteve prej lëkure)	27
(Prodhimi i drurit dhe produkteve prej druri, i letrës dhe produkteve prej letre, shtypshkrimet)	6
(Industri të tjera përpunuese)	7
Informacioni dhe komunikimi	3
Ndërtimi	10
Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i automjeteve dhe motoçikletave	7
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	9
Aktivitetet e tjera ekonomike	23

Sipas llojit të vendeve të lira të shpallura 77% prej tyre janë vende të reja pune. Më poshtë të dhënat sipas aktivitetit ekonomik:



Shërbimet e ofruara nga Zyrat e Punësimit

Pavarësisht vështirësive të tregut të punës të cilat u theksuan më tepër si pasojë e pandemisë, gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2021 janë punësuar 24,158 punëkërkues të papunë duke realizuar 104% të objektivit vjetor. Krahësuar me planin vjetor të vitit 2021:

Punësimi sipas kategorive të veçanta

	Objektivi i vitit 2021	Realizimi viti 2021	%Realizim/ Objektiv
Total punësimi	23,200	24,158	104%
Pu.Pa, me aftësi të kufizuar	50	32	64%
Pu.Pa, Romë/ Egjiptianë	750	513	68%
Pu.Pa, nga NE	1300	972	75%

Për sa i përket punësimit të Pu.Pa-ve nga kategoritë e veçanta, objektivat për aftësinë e kufizuar, romë/ egjiptian dhe ndihmën ekonomike kanë hasur vështirësi në realizimin e plotë të treguesve të vendosur. Kjo erdhi si rezultat i situatës problematike si pasojë e pandemisë dhe karakteristikave specifike të këtyre grupeve të cilat e vështirësuan akoma më tepër punësimin e tyre.

Programet e Nxitjes së Punësimit

Për periudhën Janar- Dhjetor 2021 nga zbatimi i programeve të nxitjes për vitin 2021 kanë përfituar **1,195** subjekte dhe **4,834** individë, nga të cilët **552** subjekte dhe **2,596** individë janë aplikimet e vitit të 2020 (të cilët kanë vijuar të jenë përfitues edhe në vitin 2021).

Nëse do të shohim zbatimin e programeve për vitin 2021 kemi një paraqitje të realizimit të fondit të ndarë sipas VKM, si më poshtë:

VKM	Numri i projekteve	Numri i punëkërkesve të papunë	Fondi i konfirmuar për vitin buxhetor (në lekë)
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	254	484	51,154,883
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	160	417	53,762,691
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	215	1,086	66,826,265
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	49	282	19,795,076
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	240	1,496	139,302,685
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	209	816	36,474,561
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	23	208	1,197,597
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	45	45	20,624,270
TOTALI	1,195	4,834	389,138,028

Nga totali i pjesëmarrësve në PNP gjatë vitit 2021, rreth 60% e tyre ishin femra dhe 43% të rinj të moshës 16-26 vjeç.

	Programet e mbartura		Programet e reja		Total programe të zbatuara	
	Vlera	%	Vlera	%	Vlera	%
Pjesëmarrës në PNP	2596	100%	2238	100%	4834	100%
prej tyre						
femra	1731	67%	1183	53%	2914	60%
kryefamiljarë	455	18%	185	8%	640	13%
të rinjtë 16-29 vjeç	1026	40%	1147	51%	2073	43%
nga pagesa e papunësisë	304	12%	192	9%	496	9%
nga ndihma ekonomike	120	5%	206	9%	326	5%
afatgjatë	336	13%	515	23%	851	16%
romë/ egjiptianë	103	4%	63	3%	166	3%
PAK	24	1%	33	1%	57	1%
Emigrantë të kthyer	6	0%	0	0%	6	0%

Programet e reja të Nxjitjes së Punësimit

Gjatë vitit 2021, në programet e reja të PNP u përfshinë 643 subjekte dhe 2,238 punëkërkuues të papunë. Rreth 45 % e subjekteve u përfshinë në programet e VKM Nr. 17, ndërsa 44% e punëkërkuësve të papunë përfitues morën pjesë në programet e VKM Nr. 608.

	Nr. Projektsh	Nr. Pjesëmarrësish
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	99	192
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	81	191
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	130	628
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	46	258
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	115	398
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	104	318
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	23	208
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	45	45
Total	643	2,238

Rreth 59% e numrit të pjesëmarrësve paraqiten në rajonet Tiranë, Durrës, Fier dhe Shkodër.

Rajonet	Nr Pjesëmarrësish	%
Berat	99	4%
Dibër	66	3%
Durrës	310	14%
Elbasan	198	9%
Fier	259	12%
Gjirokastrë	202	9%

Korçë	79	4%
Kukës	52	2%
Lezhë	72	3%
Shkodër	360	16%
Tiranë	383	17%
Vlorë	158	7%
Total	2,238	100%

Numri më i lartë i punësimeve nëpërmjet VKM Nr. 17 (Punësimi dhe formimi nëpërmjet punës), ishte në Industrinë Përpunuese, Akomodimin dhe Shërbimin Ushqimor, Ndërtim dhe Tregti.

Praktikat Profesionale u zhvilluan më së shumti në subjekte të cilat kanë si aktivitet ekonomik Shërbimet Administrative dhe Mbështetëse, Administrimin Publik dhe Mbrojtjen, Arsimin, Shëndetësinë dhe Aktivitetet e Mbrojtjes Sociale.

Numri më i lartë i pjesëmarrësve të punësuar me programet e VKM Nr.608 paraqitet në Industrinë Përpunuese, Akomodimin dhe Shërbimin Ushqimor, Ndërtim dhe Tregti.

Rreth 80% e pjesëmarrësve të Programit “Punët në komunitet” u punësuan në subjekte me aktivitet ekonomik Akomodimin dhe Shërbimin Ushqimor, Shërbimet Administrative dhe Mbështetëse, Administrimin Publik dhe Mbrojtjen.

Përfituesit e programit “Vetëpunësimi” u përqëndruan në aktivitete ekonomike si: Aktivitetet të familjeve si punëdhënës, Tregti dhe Aktivitete të tjera shërbimi.

	Industria Përpunuese	Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	Ndërtimi	Tregtia me shumicë dhe me pakicë; Riparimi i autove dhe motoçikletave	Transporti dhe magazinimi	Shërbime administrative dhe mbrojtje	Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm	Arsimi	Shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale	Të tjera
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	19%	15%	0%	14%	1%	1%	0%	1%	2%	46%
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	37%	23%	1%	14%	1%	1%	0%	0%	1%	23%
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	0%	1%	0%	0%	0%	16%	36%	16%	24%	7%
V.K.M 608 (Programi 4 mujon)	73%	12%	2%	4%	5%	0%	0%	0%	0%	4%

V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	56%	17%	4%	7%	2%	0%	0%	0%	0%	14%
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	48%	19%	3%	17%	1%	0%	0%	1%	0%	10%
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	0%	25%	0%	0%	0%	13%	42%	0%	0%	20%
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	2%	0%	4%	27%	0%	0%	0%	2%	4%	60%
Total	30%	13%	2%	7%	1%	6%	14%	5%	7%	15%

Kategoritë si femrat, kryefamiljarët, pagesa e papunësisë, dhe romë/ egjiptianë kanë përfituar më tepër nga programet e VKM Nr. 608. Punëkërkuessit e papunë nga ndihma ekonomike, afatgjatët dhe aftësia e kufizuar kanë përfituar më tepër nga programet e VKM Nr.17.

	Total	femra	krye-familjare	nga pagesa	nga ndihma	afatgjatë	rome/ egjiptiane	PAK
V.K.M 17 (Programi 1 Punësimi)	9%	6%	8%	3%	9%	6%	23%	57%
V.K.M 17 (Programi 2 Formimi nëpërmjet punës)	9%	10%	13%	1%	9%	10%	11%	0%
V.K.M 17 (Programi 3 Praktikat e punës)	28%	31%	2%	3%	38%	31%	11%	36%
V.K.M 608 (Programi 4 mujor)	12%	11%	31%	57%	7%	11%	14%	0%
V.K.M 608 (Programi 8 mujor)	18%	23%	19%	36%	1%	4%	2%	0%
V.K.M 608 (Programi 12 mujor/ Informaliteti)	14%	14%	10%	0%	2%	8%	5%	0%
V.K.M 535 (Punët në komunitet)	9%	4%	11%	0%	33%	28%	34%	0%
V.K.M 348 (Programi i vetëpunësimit)	2%	1%	7%	0%	1%	1%	0%	7%
	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%	100%

Në treguesit e monitorueshëm për vitin 2021 AKPA vendosi si objektiv për Programet e Nxitjes së Punësimit pjesëmarrjen në programet e reja të 1,190 punëkërkesve të papunë, objektiv i cili arriti të realizohej në masën 188%. Arsyeja e këtij tejkalimi vjen si rezultat i nisjes së programeve të reja në muajin Maj 2021, duke mundësuar pjesëmarrjen e më shumë pu.pa-ve në programe me fondin e vënë në dispozicion, si rrjedhojë e konsumimit të një fondi më të vogël për pu.pat përfitues referuar numrit të muajve që kanë përfituar.

Programet e Formimit Profesional Publik

Në periudhën Janar- Dhjetor 2021 kanë ndjekur kurset e formimit profesional **6,631** punëkërkes të papunë ose rreth **8%** të totalit të punëkërkesve të papunë të regjistruar në Zyrat e Punës. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, numri i pjesëmarrësve në kurse formimi rezulton të jetë vetëm 50% më i lartë se realizimi i vitit 2020.

Diferenca e lartë krahasuar me një vit më parë vjen si rrjedhojë e ndikimit që pati pandemia në ecurinë e kurseve gjatë 2020 të cilat për disa muaj nuk u zhvilluan.

Emërtimi i Q.F.P-së	Totali i të regjistruarve në kurse	Prej tyre		Totali i të certifikuarve	Prej tyre	
		Femra	Punëkërkes të papunë		Femra	Punëkërkes të papunë
Qfp Nr.1	1,808	871	802	923	457	351
Qfp Nr.4	1,569	642	634	942	413	368
Qfp Durrës	1,607	724	970	809	297	488
Qfp Fier	772	217	553	365	116	257
Qfp Vlorë	1,426	667	712	856	433	435
Qfp Gjirokastrë	601	227	429	413	153	291
Qfp Elbasan	1,674	669	1,023	915	379	525
Qfp Korçë	609	226	481	349	112	264
Qfp Shkodër	592	300	511	301	159	264
Qendra Lëvizëse	592	448	516	307	258	283
TOTAL 1 Kurset e reja 2021	11,250	4,991	6,631	6,180	2,777	3,526
TOTAL 2 Kurset e reja+ të mbartura	10,404	4,516	6,426	9,141	4,017	5,531

Prej totalit të 10,404 kursantëve të cilët kanë ndjekur kurset e formimit profesional gjatë vitit 2021 (të reja dhe të mbartura), rreth 88% prej tyre janë certifikuar.

Për sa i përket treguesve të formimit profesional të përcaktuar në Kartën e Per-

formancës 2021, totali i Pu.Pa-ve pjesëmarrës në formim profesional është realizuar në masën 85%, ndërsa realizimi i treguesve për grupeve të veçanta është pozitiv.

Formim profesional	Objektivi 2021	Realizimi 2021	% Realizim/ Objektiv
Pu.Pa pjesëmarrës në formim	7,810	6,631	85%
Rom/ Egjiptianë	160	155	97%
PAK	35	95	271%
Ndihmë ekonomike	250	433	173%

Pagesa e Papunësisë

Në zbatim të VKM Nr. 161/2018 “Për Pagesën e së Ardhurës nga Papunësia”, si dhe udhëzimit Nr. 17/2018 në zbatim të këtij vendimi, është realizuar ndjekja dhe monitorimi i pagesës së papunësisë nëpërmjet të gjitha kanaleve të komunikimit, si telefon, e-mail, si dhe vizita në terren.

Gjatë vitit 2021 u vu re një rënie e ndjeshme e numrit të përfituesve të pagesës së papunësisë nga 5,738 pu.pa përfitues që rezultojnë në Janar 2021, ky numër u ul në 2,914 pu.pa në muajin Dhjetor 2021. Në skemën e pagesës së papunësisë gjatë periudhës 12-mujore të vitit 2021 kanë hyrë mesatarisht 656 përfitues çdo muaj, ku peshën specifike më të madhe e zënë personat që vijnë nga zvogëlimi i aktivitetit ose prishje e kontratave të punës. Si rezultat i mbarimit të afatit të trajtimit, nga skema e pagesës së papunësisë kanë dalë mesatarisht 866 përfitues çdo muaj.

Bazuar në periudhën e përfitimit vëmë re se numri më i lartë vazhdon t'i përkasë periudhës së përfitimit prej 12 muaj. Kjo për dy arsye: periudha e kontributeve mbi 10 vjet dhe grupmosha mbi 55 vjeç për gratë dhe mbi 60 vjeç për burrat. Vërehet gjithashtu se këto dy grupmosha vazhdojnë të zënë dhe numrin më të madh të përfituesve të së ardhurës nga papunësia në total.

Fondi i shpenzuar gjatë vitit 2021 në këtë program është 930.6 milion lekë ose 99.2% e fondit të rishikuar dhe 116.3% e fondit të akorduar në buxhetin e vitit 2021.

Shtetasit e huaj të punësuar në Shqipëri

Gjatë vitit 2021, janë pajisur me leje dhe vërtetime pune 5,034 shtetas të huaj.

1. Janë pajisur me Vërtetime Deklarimi për Punësim 1,596 shtetas të huaj

- 32% janë dhënë në Ndërtim, 9% në Tregti, dhe 9% në Ansim.
- 23% janë shtetas italian, 10% kosovarë, 4% anglezë dhe 4% rumunë.

2. Janë pajisur me Leje Pune 3,438 shtetas të huaj, prej tyre:

- 13% janë dhënë në Ndërtim, 15% në Industrinë Përpunuese, 12% në Bujqësi, dhe 9% në Tregti.
- 16% janë shtetas turq, 12% egjiptianë dhe 5% filipinezë, 5% indianë dhe 4% kinëzë.



KAPITULLI II

PUNËSIMI I DENJË NËPËRMJET SHËRBIMEVE TË PUNËSIMIT DHE POLITIKAVE AKTIVE TË TREGUT TË PUNËS

Modernizimi i Shërbimit Publik të Punësimit

Gjatë vitit 2021, AKPA është angazhuar në ndjekjen e zbatimit të Sistemit Informatik të përmirësuar të Shërbimeve të Punësimit dhe të ofrimit të shërbimeve të punësimit në Zyrat e Punës. Në këtë kuadër gjatë vitit 2021, ka vijuar puna për zbatimin dhe përmirësimin e Sistemit të Shërbimeve të Punësimit duke përfshirë të gjitha programet e reja të punësimit, të cilat ofrohen ndaj punëkërkuarëve dhe punëdhënësve.

Në fillim të vitit 2021 u hartuan dhe miratuan disa udhëzues që kanë të bëjnë me proceset dhe procedurat që lidhen drejtpërdrejt me shërbimet e ofruara në zyrat e punës ndaj punëkërkuarëve dhe punëdhënësve si:

- Udhëzuesi për ofrimin e shërbimeve të punësimit për punëkërkuarët dhe punëkërkuarët e papunë;
- Udhëzuesi i Këshillimit drejt Punësimit;
- Udhëzuesi për Ofrimin e Shërbimeve të Punësimit për Punëdhënësin;
- Udhëzuesi për Orientimin në Karrierë dhe Formim Profesional;
- Udhëzuesi për Plotësimin e Vendit të Linë të Punës.

Ndërtimi i udhëzuesve për shërbimet e punësimit u shoqërua me trajnimin e stafit të gjithë zyrave të punësimit referuar koncepteve e reja të krijuara në këtë kuadër dhe ndërthurjes së tyre me Sistemin e Shërbimeve të Punësimit, me qëllim zbatimin konkret të Manualit të ri të Shërbimeve të Punësimit.

Manuali i ri shërbimeve është konceptuar si një përmbledhje e të gjithë udhëzuesve të shërbimeve të punësimit. Gjatë vitit 2021, në këtë kuadër u realizua pajisja me Planin Individual të Punësimit (PIP) e punëkërkuarëve të regjistruar në databazë (mbi 60 mijë punëkërkuarë të pajisur me PIP). Manuali i ri shërbimeve është kaluar për konsultim në Këshillin Konsultativ të Punësimit, me qëllim informimin e përfaqësuesve kryesorë të punëdhënësve dhe punëmarrësve mbi këto zhvillime që synojnë përmirësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe trajtimin e punëkërkuarëve më shërbime sipas karakteristikave dhe kategorisë. Objektivi i AKPA për vitin e ardhshëm, është realizimi i vlerësimit të cilësisë së ofrimit të shërbimeve nga zyrat e punësimit. AKPA në të njëjtën kohë nëpërmjet kanaleve të saj të komunikimit ka kryer informime të vazhdueshme mbi zhvillimet dhe format e reja të shërbimeve të punësimit.

Në funksion të rritjes së mekanizmave që përmirësojnë shërbimet ndaj punëkërkuarëve dhe modernizimit të shërbimit publik të punësimit, AKPA ka zhvilluar disa instrumenta që lehtësojnë kushtet e punës dhe shërbimet si këndet e vetshërbimit, ofrimin e shërbimeve të dedikuara nëpërmjet bashkëpunëtorëve të jashtëm dhe krijimin e statusit pezull për punëkërkuarët me probleme sociale që parashikon adresimin e çështjeve/problematikave sociale nëpërmjet referimit të tyre drejt institucioneve përkatëse në formë të institucionalizuar.

Modernizimi i infrastrukturës dhe sistemeve të teknologjisë në AKPA

Sa i përket modernizimit dhe rikonstruktimit të infrastrukturës fizike të Zyrave të Punësimit të Agjencisë, nga 40 zyra punësimi, 36 prej tyre janë të rikonstruktura dhe është parashikuar dhe rikonstruktimi i 3 zyrave të tjera, më konkretisht

Dibër, Burrel dhe Delvinë.

Gjithashtu, përmes bashkëpunimeve me partnerët strategjikë të institucionit, Zyrat e Punës janë mbështetur në vazhdimësi me pajisje si kompjutera, bazë materiale etj. Gjatë vitit 2021, në kuadër të modernizimit të zyrave vendore të punësimit dhe rritjes së mundësive për vetëshërbim, është realizuar pajisja me 45 kompjutera dhe UPS të rinj, ndërkohë që në fund të po këtij viti filloi dhe procesi i shpërndarjes së pajisjeve të ofruara nga një tjetër marrëveshje nëpërmjet së cilës parashikohet shpërndarja e 45 kompjuterave dhe UPS të tjerë si dhe të 37 televizorëve. Fuqizimi i infrastrukturës kompjuterike të zyrave mbetet një prioritet pasi me vënien në funksion të plotë të sistemit të ri të unifikuar, ky i fundit do të duhet t'i përgjigjet në mënyrë të përshtatshme standardeve të parashikuara të ofrimit të shërbimeve.

Sa i përket Sistemi Informatik të Shërbimeve të punësimit, ai u kalua live në muajin Prill 2021, prej kur të gjitha shërbimet publike që AKPA ofron u lëvruan nëpërmjet këtij sistemi. Për shkak të kompleksitetit, modulet e sistemit janë ko-lauduar gradualisht, kjo për arsye të përshtatjes së të gjithë proceseve të tij me konceptet e pasqyruara në udhëzuesit e rinj. Stafi i AKPA ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme testimin, popullimin me të dhënat për modulet e punëdhënësit, punëkërkuarit dhe vendeve të lira të punës, koordinimin, përmirësimin e funksionaliteteve, si dhe ofrimin e trajnimeve bazë të punonjësve të shërbimeve të punësimit të të gjitha zyrave vendore, në ambientet e AKPA-s. Në të njëjtën kohë është dhënë mbështetje dhe ndihmë e vazhdueshme nga sektori i shërbimeve të punësimit për çdo njësi varësie.

Në kuadër të zbatimit të sistemit të ri të shërbimeve, AKPA ka strukturuar Web-faqen e re me informacion të përditësuar dhe me të dhënat e tregut të punës, në përputhje me kalendarin e statistikave të publikueshme. Ky zhvillim synon ta kthejë AKPA-në jo vetëm në një institucion që siguron të dhëna për palë të tjera, por në një institucion gjenerues të dhënash.

Paralelisht me Web-faqen e institucionit është vënë në funksion dhe portali i ri i punësimit i cili është i lidhur me sistemin e ri, çka siguron një efikasitet të lartë të publikimit të kërkesë-ofertës dhe ndërlidhjes midis tyre.

Përmirësimi funksional i strukturave të ofrimit të shërbimeve të punësimit

Një ndër proceset që ka vijuar të ndiqet me prioritet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive gjatë vitit 2021 ka qenë procesi i fuqizimit të strukturave dhe burimeve njerëzore, në vijim të ristrukturimit në nivel qendror dhe rajonal të ndodhur në 2 vitet e mëparshme. Strukturat e reja parashikojnë:

- ndarjen e roleve dhe përgjegjësi,
- profilizimin e qartë të punonjësve,
- optimizimin e punës, si dhe
- ofrimin e një shërbimi të përshtatshëm për punëdhënësit dhe punëmarrësit.

Të gjitha zyrat e punësimit janë riorganizuar dhe operojnë sipas modelit të ri të shërbimeve të punësimit duke u bazuar në standardizimin e proceseve të punës dhe profilizimin e punonjësve. Ky proces është shoqëruar gjithashtu me ofrim-

in e mbështetjes dhe trajnimeve të vazhdueshme për zbatimin e sistemit të ri informatik.

Gjatë vitit 2021, janë realizuar 355 trajnime për ngritjen e kapaciteteve të stafit (në këtë numër një person mund ketë marrë më shumë se një trajnim).

Për programet e reja të nxitjes së punësimit si Punët Publike në Komunitet dhe Vetëpunësimi, të cilat u zbatuan plotësisht në vitin 2021, janë trajnuar 77 persona, me mbështetjen e UNDP.

Gjithashtu, në kuadër të Komponentit të parë të projektit “Asistencë Teknike për Mbështetjen e Reformës në Politikën e Punësimit dhe Arsimit dhe Formimit Profesional” (IPA), është ndërmarrë procesi i analizimit të nevojave për trajnim (TNA) të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Raporti u finalizua në nëntor të vitit 2021 duke ofruar një sërë rekomandimesh për zhvillimin dhe menaxhimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore brenda AKPA-s.

Metodologjia e përdorur për TNA është zhvilluar në disa faza:

1. Analizimi i situatës aktuale të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të AKPA-s.
2. Analizën fillestare e stafit, ku u kryen intervista dhe sesionet e fokus grupeve me stafin e AKPA-s (niveli qendror, rajonal dhe vendor), intervistat me partnerët socialë,
3. Analizë e detajuar, përmes së cilës u zhvillua një anketim online duke përfshirë katër drejtori qendrore të AKPA-s dhe tre drejtori rajonale (duke targetuar drejtorët, përgjegjësit e sektorëve dhe specialistët).

Rezultatet e TNA-së kanë vlerë të shumëfishtë, një prej të cilave është hartimi i paketave të trajnimit për grupe të veçanta për stafin e AKPA-s dhe hartimi i planeve të ngritjes së kapaciteteve në kuadër të mbështetjes së projektit. Përveç kësaj, si rezultat i kësaj analize u zhvillua një Matricë e Nevojave për Trajnim, si instrument kyç për zbatim nga institucioni.

Për të rritur kapacitetet dhe përgatitur stafin e AKPA-s në lidhje me Menaxhimin e Ciklit të Projekteve dhe Skemave të Granteve nën Instrumentin për Asistencën e Para-Aderimit (IPA III) të BE-së, janë zhvilluar dy trajnime të thelluara me nga 15 pjesëmarrës secili:

1. Trajnim mbi Menaxhimin e Ciklit të Projekteve të BE-së;
2. Trajnim mbi Menaxhimin e Skemave të Granteve të BE-së.

Në vijim, gjatë vitit 2022, nga projekti IPA II pritet të zhvillohen dhe ofrohen paketa trajnime për stafet e Zyrave të Punës mbi shërbimin ndaj Punëkërkuesit, ndaj Punëdhënësit si edhe mbi menaxhimin dhe lidhësin.

Diversifikimi i Programeve Aktive të Tregut të Punës

Në zbatim të Programit të Qeverisë dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për mbështetjen e punëkërkuesve të papunë me programet aktive të Nxitjes së Punësimit, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, në vitin 2021 zbatoi programet e reja si më poshtë vijon:

- VKM Nr. 17, datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”, i ndryshuar,
- VKM Nr. 348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet Vetëpunësimit”,
- VKM Nr. 535, datë 8.7.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve Publike në Komunitet”,
- VKM Nr. 608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”, i ndryshuar.

Programet e nxitjes së punësimit janë konceptuar në formë të tillë që të adresojnë dhe nevojat e kategorive të disavantazuara të punëkërkuesve të papunë. Pas pilotimit në 4 rajone në vitin 2020, VKM-ja Nr.348 për Vetëpunësimin, gjatë vitit 2021 u zbatua me sukses në të gjitha rajonet.

Në të njëjtën kohë gjatë vitit 2021 u zbatua për herë të parë me sukses programi i Punëve Publike në Komunitet. Në këtë program numri i përfituesve ishte 207 persona. Nëpërmjet këtij programi kryesisht targetohen kategoritë e vështira dhe punëkërkuesit e papunë afatgjatë të cilët e kanë të vështirë të integrohen në tregun e punës.

Gjatë vitit 2021, pas ndjekjes dhe monitorimit të ecurisë së zbatimit të programeve aktive të tregut të punës u evidentuan problematika të cilat kishin nevojë për adresim. Në këtë kuadër, u amendua VKM-ja nr. 608 për arsye të moszbatimit të programeve 8 dhe 12 mujore si pasojë e kufizimit të afatit të zbatimit të këtij programi deri më 31.12.2021. Me ndryshimin e fundit të kësaj VKM-je, i cili u miratua me VKM Nr. 578, datë 06.10.2021, afati i zbatimit të kësaj skeme u shty deri në fund të vitit 2023. Në të njëjtën kohë u zgjerua dhe fasha kohore e punëkërkuesve të papunë të regjistruar në zyrat e punës të cilët mund të përfitonin. Gjithashtu, në kontekstin e përmirësimeve të programeve të nxitjes së punësimit janë dërguar propozime për ndryshime të VKM-së nr. 17.

Në kuadër të diversifikimit të PAPTP-ve, ka nisur hartimi i programit të Garancisë Rinore, e cila po mbështetet nga asistenca teknike IPA II. Aktualisht është kryer analiza e situatës aktuale e cila siguron një panoramë fillestare të problematikave të NEET në Shqipëri, kuadri fillestar i Programit të Garancisë Rinore, si dhe është realizuar hartëzimi i NEET në Shqipëri. Të dhënat e pasqyruara nga hartëzimi i NEET mbulojnë 4 vitet e fundit nga Anketa e Forcës së Punës në Shqipëri. Synohet që programi të pilotohet me 200 të rinj brenda vitit 2022.

Përmirësimi i procesit të planifikimit dhe zbatimit të programeve të nxitjes së punësimit

Planifikimi dhe shpërndarja e fondeve të vitit 2021, është referuar dhe në përputhje me udhëzimin nr. 25, datë 16.06.2020, i cili përcakton metodologjinë e shpërndarjes së fondeve të programeve të nxitjes së punësimit. Realizimet e indikatorëve dhe fondi i shpenzuar monitorohen në mënyrë të vazhdueshme, ku

në bazë të realizimeve kryhen ndryshime dhe nishpërndarje të indikatorëve dhe fondeve. Në bazë të të dhënave, rezulton se ka patur një shpërndarje mjaft pozitive të fondeve për sa i përket aspektit gjinor pasi në fund të vitit 2021, nga numri total i përfituesve prej 4834 individësh, 3653 janë gra /vajza ose 76 % e totalit.

Fuqizimi i Dialogut Social

Në kuadër të fuqizimit të dialogut social për Kontratat kolektive dhe Mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve gjatë 2021, janë kryer kurse të trajnimit për të gjithë specialistët e Drejtorive Rajonale të AKPA-as në 12 Rajone, (ndërmjetësit dhe specialistë shërbimesh) për kryerjen e ndërmjetësimit/pajtimimit në rastet e mosmarrëveshjeve të punës. Këto trajnime janë organizuar nga Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit të ILO, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë si dhe mbështetjen e AKPA. Gjithashtu është konceptuar Databaza Kombëtare si regjistër i krijuar dhe funksional brenda funksionaliteteve të sistemit informatik të SHP.

Rrjeti i ndërmjetësimit është ngritur dhe në çdo zyrë njëri prej punonjësve është përgjegjës për ndërmjetësimin. Për shkak të rristurimit gjatë vitit 2021 është bërë përditësimi i listës së personave përgjegjës për ndërmjetësimin dhe kjo listë është miratuar në MFE. Në sistemin e ri të shërbimeve të punësimit mosmarrëveshjet janë pjesë e modulit të punëdhënësit në formën e një regjistri të thjeshtë.



KAPITULLI III

OFRIMI I ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL CILËSOR

Optimizimi i Ofruesve të AFP-së

Një nga prioritetet më të rëndësishme të vitit 2021 në fushën e AFP-se ka qenë riorganizimi i ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional, në kuadër edhe të asistencës së IPA-s. Qëllimi i procesit është Optimizimi i Ofruesve të AFP-së në nivel individual dhe rrjeti për të siguruar një ofertë më cilësore dhe të larmishme, në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Në vijim të zbatimit të masave të Strategjisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022 është realizuar procesi i analizës dhe përgatitjes së propozimeve për optimizimin e ofertës së arsimit dhe formimit profesional, i cili synon hartimin e një dokumenti nëpërmjet të cilit do të orientohet oferta e ofruesve të AFP-së në vijimësi. Organizimi i ofruesve, parashikohet të rishikohet jo vetëm në optikën se çfarë ofruesish operojnë aktualisht, por dhe të kombinimit që do të kemi të qendrave shumë funksionale, shkollave dhe qendrave të formimit profesional.

- Bazuar në strukturën bazë të miratuar me udhëzimin Nr. 14 do të hartohen nën asistencën e IPA-s (projekti SREPVET) strukturat për çdo ofrues të optimizuar.
- Është realizuar përgatitja e dosjeve të plota të personelit për të gjithë drejtuesit IOAFP ku janë grumbulluar të gjithë informacionet mbi dosjet personale të drejtuesve të çdo IOAFP dhe janë administruar në AKPA.
- Është kryer procesi paraprak i inventarizimit të infrastrukturës dhe burimeve njerëzore aktuale nëpërmjet aplikacionit të statistikave zyrtare.

Në kuadër të procesit të Optimizimit janë identifikuar aktet nënligjore përkatëse për t'u hartuar në plotësim të kuadrit rregullator në fushën e AFP-së. Për vitin 2021 janë draftuar dhe miratuar aktet nënligjore si më poshtë:

- Udhëzimi nr. 14 datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarisë së institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, si dhe aspektet e menaxhimit të burimeve njerëzore, përbërjes së njësisë së zhvillimit të ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit";
- Ndryshimi i Udhëzimit nr. 28, datë 14.10.2019 'Për numrin e nxënësve për klasë dhe normat e punës mësimore në institucionet e arsimit profesional' (në proces konsultimi);
- Rregullorja e Brendshme Tip e IOAFP-së;
- Rregullorja e Bordit Drejtues;
- Rregullorja e Komisionit të Etikës dhe Sjelljes, Kodi i Etikës;
- Rregullorja e Komisionit të Disiplinës;
- Rregullorja e Këshillit të Prindërve;
- Rregullorja e qeverisë së nxënësve të institucionit;
- Metodologjia për hapjen e një kursi të ri në DROFPP;
- Udhëzuesi mbi Menaxhimin e Shërbimit "Aplikim për regjistrim për kurs formimi profesional";
- Sistemi i referimit për kurset profesionale në DROFPP dhe DRAKPA.

Infrastruktura, investimet në Ofruesit Publik të AFP-së

Një element i rëndësishëm në rritjen e cilësisë së mësimdhënies në ofruesit pub-

lik të AFP- së janë investimet në infrastrukturë. Sa i përket këtij komponenti, DMOAFP-ja ka identifikuar të gjithë problematikat dhe nevojat për ndërhyrje të plotë dhe të pjesshme në infrastrukturë sipas 4 rajoneve kryesore.

Në të njëjtën kohë, është kryer ndjekja e procedurave të rekrutimit të ofruesit publik të AFP-së në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse si edhe në kuadër të fillimit të vitit të ri shkollor 2021-2022, ka përfunduar procesi i shpërndarjes së normave mësimore për stafin mësimdhënës në çdo shkollë. Bazuar në këtë shpërndarje secila shkollë profesionale ka identifikuar dhe dërguar në DMOAFP nevojat për staf shtesë si në mësimdhënie edhe në sektorin mbështetës.

Së fundmi janë identifikuar dhe referuar në AKAFPK dhe ASCAP nevojat për trajnim të mësimdhënësve të AFP-së në nivel kombëtar dhe në nivel ofruesi.

Diversifikimi i Ofertës në AFP në Përputhje me Nevojat e Tregut të Punës

Me qëllim rritjen e cilësisë së programeve të kurseve afatshkurtra për formim profesional, të cilat ofrohen nga Qendrat Publike të Formimit Profesional, AKPA ka ndër marrë një sërë masash:

Janë miratuar 2 kurrikula në nivel ofruesi:

Kurrikula “Aftësi digjitale”, e cila trajton 5 kompetencat bazë digjitale sipas EU Digital Competencies Framework 2.0., që është konceptuar për t’i shërbyer të gjithë qytetarëve, punëkërkuessve të cilët duan të zhvillojnë njohuritë e tyre në fushën e teknologjisë së informacionit.

Kurrikula “Përpunues i frutave dhe perimeve”, e cila synon të aftësojë kursantët për kryerjen e detyrave profesionale si i punësuar në kompani të ndryshme shërbimesh, prodhimesh ushqimore, në shoqëri tregtare që kanë reparte të shërbimit ushqimor apo si i vetëpunësuar për përpunim të frutave dhe perimeve.

Me qëllim sigurimin e plotësisht të nevojave të tregut të punës për kualifikime profesionale, si dhe në bazë të kërkesave nga shkollat e mesme profesionale, gjatë vitit 2021 janë miratuar nga MFE propozimet nga Agjencia Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për:

a) hapjen e 2 drejtimeve pas të mesme, përkatësisht:

- Drejtimit pas të mesëm “Diagnostikim-Menaxhim në Autoservis” në shkollën profesionale Industriale “Pavarësia”, Vlorë.
- Drejtimit të ri pas të mesëm “Diagnostikim – Menaxhim në Autoservis” në shkollën profesionale “Stiliano Bandilli”, Berat.

b) Hapja e dy drejtimeve të reja, përkatësisht:

- Drejtimi “Mekanikë” në shkollën e mesme profesionale “Beqir Çela”, Durrës
- Drejtimi “Teknologji Ushqimore” në shkollën e mesme profesionale “Mihal Shalini”, Cërrik

c) Hapja e tre kurseve të reja në DROFPP, përkatësisht:

- “Administrator ndërtesash” në DROFPP Vlorë,
- “Modelim veshjesh për femra” në DROFPP Durrës;
- “Përpunim i frutave dhe perimeve” në DROFPP Elbasan.

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka vijuar punën për planifikimin dhe kryerjen e kostimit të kurrikulave që zbatohen në DROFPP-të, në përputhje me hapat e përcaktuar në metodologjinë e kostimit.

Përmirësimi dhe zbatimi i procedurave të licencimit dhe monitorimit të ofruesve privatë të AFP-së

Sa i përket monitorimit të subjekteve private, AKPA ka realizuar procesin e monitorimit/ vlerësimit të subjekteve private të licencuara për "Formim Profesional" në Kodin X.2.B nga viti 2009 deri në 2021, në shkallë vendi me mbështetjen e GIZ/ ProSEED.

Gjithashtu AKPA gjatë vitit 2021, në kuadër të përmbushjes së funksioneve të saj ka kryer veprimtarinë e mëposhtme:

- Janë ndjekur dhe shqyrtuar 188 kërkesa/aplikime të subjekteve private për Licencën e Formim Profesional në Kodin X.2.B, të cilat administrohen nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Biznesit.. 67% e totalit të kërkesave/aplikimeve janë subjekte të cilat ushtrojnë aktivitetet në Tiranë (116 subjekte). Nga ana tjetër, është trajtuar vetëm një kërkesë/aplikim për Licencë "Arsim të Mesëm Profesional" në Kodin IX.1.A.6, për të cilën grupi i punës i përbërë me përfaqësues të MFE, AKAFPK dhe AKPA ka dhënë vlerësim pozitiv.
- Kanë informuar mbi aktivitetin formues profesional 159 subjekte. Tirana, ka numrin më të madh të subjekteve që deklarojnë si dhe personave të trajnuar, me 93 subjekte dhe 5915 të trajnuar. Nga përpunimi i të dhënave, rezulton të jenë trajnuar 7588 persona, prej të cilëve 3776 femra dhe 3038 të papunë. Njëkohësisht është mbajtur regjistri i të certifikuarve në këto subjekte për vitin 2021.

Me qëllim përmirësimin e procedurave të licencimit dhe monitorimit të ofruesve privatë të AFP-së, gjatë vitit 2021, AKPA ka:

- hartuar draftin me ndryshimet përkatëse të Udhëzimit nr. 1457, për shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave të subjekteve private për Licencë Formimi Profesional dhe është kaluar për mendim tek anëtarët e grupit.
- automatizuar procesin e monitorimit të ofruesve privatë të AFP-së, nëpërmjet modulit të shërbimeve ndaj punëdhënësit në sistemin informatik të shërbimeve të punësimit dhe testimit të tij. Aktualisht janë regjistruar në sistem 231 subjekte private të licencuar për "Formim Profesional" në Kodin X.2.B.



KAPITULLI IV

PËRFSHIRJA SOCIALE DHE KOHEZIONI TERRITORIAL

Vlerësimi i nevojave për shërbime të punësimit dhe të formimit në zonat e pambuluara

Duke vlerësuar maksimalisht rëndësinë e kohezionit territorial dhe bashkëpunimit ndërinstitucional për nevojat e punëkërkuarve, AKPA ka iniciuar nënshkrimin e Marrëveshjeve të Bashkëpunimit me bashkitë kryesore sipas qarqeve të vendit. Qëllimi i tyre konsiston në ndërtimin e një marrëdhënie dypalëshe me qëllim shërbimin e institucionalizuar, ndihmën ndaj punëkërkuarve për punësimin e tyre të denjë dhe adresimin sa më efektiv të problematikave sociale me të cilat përballen ata. AKPA, gjatë viteve 2019-2021 ka nënshkruar 16 marrëveshje bashkëpunimi me 16 njësi të qeverisjes vendore; përkatësisht me: Bashkinë Elbasan, Gramsh, Librazhd, Peqin, Cërrik, Prrenjas, Fier, Lushnje, Patos, Rroksvec, Korçë, Maliq, Lezhë, Laç, Mirditë dhe Delvinë.

Në fund të vitit 2021, AKPA ka iniciuar hartimin e një metodologjie për mënyrën sesi do të mund të realizohet shtrirja territoriale e zyrave të punësimit në përputhje me nevojat e popullatës për përfitim të shërbimeve duke u mbështetur në principet e efikasitetit dhe fizibilitetit të resurseve njerëzore, infrastrukturore dhe financiare. Instrumenti i cili do të përmbajë kritere dhe standarde të qarta do të ndihmojë për vendimarrjet që lidhen me shtrirjen territoriale dhe aksesueshmërinë e sporteleve në respektim të të drejtave të qytetarëve.

Në kuadër të procesit të optimizimit është finalizuar analiza për nishpërndarjen e ofruesve aktualë të AFP në përputhje me parimin e efikasitetit dhe mbulimit të zonave gjeografike në formë efikase. Vetëm pas finalizimit të këtij procesi, do të mund të nis vlerësimi i detajuar i nevojave për shërbime të formimit në zonat e pambuluara. Gjatë vitit 2021 janë hartuar akte rregullatore për mbështetjen e këtij procesi si dhe është kryer inventarizimi i burimeve njerëzore dhe infrastrukturorë mbi të cilin do të kryhet rialokimi i këtyre burimeve bazuar në planin e optimizimit i cili pritet të miratohet dhe zbatohet gjatë vitit 2022.

Zbatimi i parimit të Përfshirjes Sociale në ofrimin e shërbimeve të punësimit dhe Formimit

Fusha e punësimit

Në sistemin e ri të shërbimeve të punësimit është përcaktuar përgatitja e Planit Individual të Punësimit për çdo punëkërkuar të papunë të regjistruar. Nga vlerësimi që i bëhet punëkërkuarve të papunë nga këshilluesi përcaktohen edhe paketat e shërbimeve të cilat i përshtaten atij me qëllim riintegrimin në tregun e punës. Gjithashtu, nëse konstatohet se për një punëkërkuar të papunë ekzistojnë pengesa të tjera si këshillime të specializuara, mungesa e kopshteve dhe çerdheve etj., në sistem është parashikuar edhe referimi i tyre në OJF ose njësitë e qeverisjes vendore. Në këtë rast punëkërkuarësi i papunë merr statusin pezull.

Me qëllim rregullimin e sistemit të referimit, AKPA në bashkëpunim me UNDP ka hartuar një Udhëzues për menaxhimin e integruar të rastit ZP& NJVNR. Ky Udhëzues synon hartimin dhe pilotimin e një modeli të menaxhimit të integruar të rastit (MIR) mes dy shërbimeve, për t'iu përgjigjur mes përfituesve të ndihmës ekonomike (NE), atij grupi përdoruesish të shërbimit me nevoja shumëfishe psiko-sociale dhe shëndetësore, të cilët kanë nevojë për një qasje individuale in-

tensive, për të siguruar fuqizimin dhe lehtësimin e integritetit të tyre në tregun e punës.

Në kuadër të bashkëpunimit të AKPA me Shërbimin Social Shtetëror (ShSSH), dhe me mbështetjen e UNDP, gjatë vitit 2021 është realizuar pilotimi i zbatimit të këtij Udhëzuesi me Bashkinë Elbasan dhe administratorët socialë.

Gjatë vitit 2021 është nënshkruar Marrëveshja me GIZ /PME për mbështetje e 5 Drejtorive Rajonale të Punësimit dhe Bashkive respektive si edhe me partnerët sociale për institucionalizimin e bashkëpunimit trepalësh për grupet vulnerabël. Pilotimi është parashikuar të nis gjatë vitit 2022.

Ndërkohë AKPA në kuadër të Strategjisë për Mbrojtjen Sociale ka vijuar të ketë prioritet përfshirjen e kësaj kategorie në programet aktive të tregut të punës.

Më poshtë të dhënat për vitin 2021:

- Punësimi i 185 përfituesve të mëparshëm dhe 972 përfituesve të NE;
- Pjesëmarrja e 59 përfituesve të mëparshëm dhe 326 përfituesve në programe aktive të tregut të punës;
- Pjesëmarrja e 15 përfituesve të mëparshëm dhe 433 përfituesve në kurse të formimit profesional.

Fusha e Arsimit dhe Formimit Profesional

Me qëllim përfshirjen sociale, në të gjitha rikonstruksionet e infrastrukturës fizike të ofruesve të AFP-së të realizuara në vitet e fundit, është bërë përshtatja e ambienteve për nxënësit/ kursantët me aftësi të kufizuara.

Gjithashtu, në këtë kuadër, është miratuar kurrikula për gjuhën e shenjave dhe janë trajnuar në DROFPP nr.4, Tiranë, 15 instruktorët e parë që do të ofrojnë këtë kurrikul

Në vijim, AKPA ka draftuar Udhëzimin për mësuesit ndihmës në institucionet arsimore të arsimit profesional, i cili pritet të miratohet gjatë vitit 2022.



KAPITULLI V

FORCIMI I MARRËDHËNIEVE DHE BASHKËPUNIMIT ME PUNËDHËNËSIN

Partneriteti me Punëdhënësin ka qenë në fokusin kryesor të AKPA-s për vitin 2021. Mbështetja për punëdhënësin përmes programeve tona të nxitjes së punësimit është një hap i rëndësishëm për përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale, duke ngritur mekanizmat përkatës që ndikojnë në rritjen e punësimit

Gjatë muajit nëntor 2021, Agjencia Kombëtare e Punës dhe Aftësive ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Autoritetin Portual të Durrësit, në kuadër të së cilit u hartua plani i aktiviteteve. Faza përgatitore përfshin fushat e mëposhtme të bashkëpunimit:

1. Vlerësimin e Nevojave të Tregut të Punës në fushën e Detarisë;
2. Integrimin e Sistemeve të Informacionit;
3. Zhvillimin e Kurrikulave në Fushën e Detarisë;
4. Promovimin e Aktiviteteve;
5. Aktivitete Ndërhyrje.

Ngritja e Bordeve të Bashkëpunimit Rajonal

Në kuadër të forcimit të marrëdhënieve dhe bashkëpunimit me punëdhënësin, AKPA gjatë vitit 2021 inicioi ngritjen e Bordeve të Bashkëpunimit Rajonal me punëdhënësit. Bordet janë konceptuar të jenë të përfshijnë:

- Drejtorin e Drejtorisë Rajonale të Punësimit
- Drejtorët e Shkollave Profesionale
- Drejtorët e Qendrave të Formimit Profesional Publik për secilin Rajon
- Përfaqësues nga entet publike rajonale
- Përfaqësues nga partnerët socialë
- Përfaqësues nga organizata e punëdhënësve private
- Përfaqësues nga Bashkitë përkatëse

Rolet kryesore të Bordeve të bashkëpunimit Rajonal të AKPA-s me punëdhënësit do të jenë:

- Përgatitja dhe informimi i aktorëve të tregut të punës së shërbimeve që AKPA;
- Përcaktimi i periodicitetit të takimeve;
- Koordinimi i punës në Rajon;
- Identifikimi i Punëdhënësve privat me të cilët do të bashkëpunohet;
- Ndarja e punëdhënësve sipas sektorëve ekonomik;
- Përcaktimi i nevojave për takime sektoriale;
- Mbledhja e nevojave të Punëdhënësit për profesione të caktuara dhe trajnime;
- Krijimi i planit të punës për mbulimin e nevojave të Punëdhënësit;
- Ndjekja e planit të punës deri në realizimin e tij dhe mbulimi në kohë i nevojave të Punëdhënësit;
- Krijimi i network-ut rajonal të bashkëpunimit.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Bordet Rajonale të Punësimit, gjatë vitit 2021, AKPA ka inicuar një studim në fushën e detarisë në Rajonin e Durrësit, Lezhës dhe Vlorës. Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij studimi ishte plotësimi i një pyetësori me një grup të synuar punëdhënësish në secilin Rajon ku është ngritur bordi. Rekomandimet e studimit të kryer do të

shërbejnë si udhërrëfyes për përmirësimin e mëtejshëm të qasjes dhe shërbimeve që AKPA ofron ndaj punëdhënësve dhe punëkërkuësve.

Analiza Rajonale e Tregut të Punës

Gjatë vitit 2021, AKPA me mbështetjen e RISI Albania ka realizuar Analizën Rajonale të Tregut të Punës dhe Zhvillimit Ekonomik në qytetin e Elbasanit në kuadër të së cilës u realizuan takime me biznese të ndryshëm si dhe me përfaqësues të Bashkisë Elbasan. Analiza fokusohet në vlerësimin e situatës aktuale ekonomike dhe nevojave të tregut rajonal të punës dhe zhvillimit ekonomik të rajonit. Analiza vjen pas situatës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, e cila ka krijuar një kontekst të ri në aspektin e zhvillimit ekonomik.

Gjetjet dhe rekomandimet e analizës rajonale e tregut të punës në Elbasan, japin një pasqyrë të nevojave për ndërhyrje për t'ju përshtatur kërkesave të reja të tregut të punës dhe diversifikimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional.

Fondi Social

Në lidhje me Fondin Social të Punësimit për kategorinë PAK, është miratuar VKM Nr. 177 datë 26.02.2020 "Për Përbërjen, Kriteret Dhe Detyrat e Bordit të Administrimit të Fondit Social të Punësimit dhe Mënyrat e Përdorimit të Tij". Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë përbërjen, kriteret dhe detyrat e Bordit të Administrimit të Fondit Social të Punësimit si dhe mënyrat e përdorimit të tij, kushtet dhe kriteret e aplikantëve.

Në kuadër të zbatimit të Fondit Social, janë miratuar kriteret dhe baza ligjore për ngritjen e sekretariatit dhe me përcaktimin e agjentit tregtar ai do të jetë funksional. Janë propozuar gjithashtu ndryshimet ligjore për funksionalizimin e këtij programi dhe përcaktimin e agjentit që do të kryejë mbledhjen e detyrimit financiar.



KAPITULLI VI

ZBATIMI I KORNIZËS SË MONITORIMIT DHE MATJES SË PERFORMANCËS

Planifikimi dhe instrumentet e monitorimit të brendshëm institucional

AKPA ka hartuar Planin Vjetor të Veprimit të institucionit për vitin 2021, i cili do të shërbejë si model për planifikimin, ndjekjen dhe monitorimin e aktiviteteve. Në këtë kuadër, janë hartuar instrumentat monitorues dhe matjes së performancës, si më poshtë vijon:

- Plani i punës së AKPA 2021
- Harta e Procesteve të Punës për çdo drejtori,
- Gjurmët e Auditit për çdo drejtori,
- Manuali i Procesteve të Punës

Karta e Performancës

Gjatë vitit 2021, AKPA hartoi dhe monitoroi kartat e performancës për Zyrat e Punës dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik.

Karta e treguesve të monitorueshëm për Zyrat e Punës përcakton arritjet vjetore të indikatorëve më të rëndësishëm që masin nivelin e shërbimit të Zyrës së Punës sipas klientëve të saj: punëkërkuarit dhe punëdhënësit. Treguesit kryesor të performancës si punësimet, përfshirja në programet aktive të tregut të punës, numri i VLP-ve të shpallura dhe rritja e numrit të punëdhënësve klientë të ZP, detajohen edhe në tregues të tjerë që i referohen prioritizimit të grupeve vulnerabël në zbatim të treguesve të strategjive përkatëse dhe indikatorëve të tjerë strategjik.

Treguesit e monitorueshëm për vitin 2021 janë përcaktuar duke marrë në konsideratë gjithë aktivitetet e nevojshme që Zyrat e Punësimit duhet të ndjekin në kuadër të riformatimit strukturor dhe IT, situatën e krijuar prej COVID-19, indikatorët e përcaktuar në strategjitë e ndryshme, realizimin e treguesve për vitin 2020 dhe fondet në dispozicion për zbatimin e PATP-ve gjatë 2021.

Sa i përket treguesve të Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publike, seti i indikatorëve që përmban kjo kartë ndërthuret me Kartën e Treguesve të Monitorueshëm të Zyrave të Punës, duke unifikuar objektivat e përbashkët.

Gjurmimi i të certifikuarve dhe diplomuarve të AFP-së

Ndërkohë që gjatë vitit 2021, me rekrutimet e reja në sektorin përkatës, u bë funksionale dhe njësia që mbulon Call Centerin, e cila ka për funksion kryejnë procesin e gjurmimit dhe të analizave mbi punësimin dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve të punësimit, arsimit dhe formimit profesional. Në bashkëpunim me Skills for Job u ndërtua metodologjia e gjurmimit për arsimin dhe formimin profesional. Pas ndërtimit të instrumentave të tillë si pyetësori u krye dhe trajnimi i stafit përkatës. Duke qenë se gjurmimi në nivel kombëtar nga AKPA po kryhej për herë të parë u vendos që ai të realizohej në formë censusi. U përgjigjën mbi 6000 të intervistuar. Në muajin Qershor, në përfundim të procesit, u realizua analiza dhe gjetjet e gjurmimit për të diplomuarit dhe certifikuarit e AFP. Gjurmimi parashikohet të kthehet në një instrument të qëndrueshëm i cili do të zhvillohet nga njësia përgjegjëse në AKPA në mënyrë të përvitshme duke mundur në këtë mënyrë dhe realizimin e analizave krahasimore. Duke iu referuar përvojës së krijuar ka nisur puna për realizimin e këtij procesi dhe për vitin 2022.

Ngritja e sistemit të monitorimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional

Me qëllim ngritjen e sistemit të monitorimit të ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional, gjatë vitit 2021, me mbështetjen e Sëisscontact, AKPA ka miratuar dhe vënë në zbatim aktet rregullatore si më poshtë:

- Harta dhe Manuali i Proçeseve të Punës,
- Gjurma e auditit,
- Regjistri i riskut,



KAPITULLI VII

TRANSPARENCA, KOMUNIKIMI DHE MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

Strategjia e Komunikimit

Strategjia e Komunikimit, e ndërtuar me mbështetjen e projektit SREPVET, “Asistencë Teknike për Reformën në Politikën e Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional” synon të ndihmojë AKPA për shpërndarjen e informacionit dhe ndërgjegjësimin rreth punës së tyre mbi ndikimin e reformës dhe ndryshimet që ajo sjell. Strategjia gjithashtu ndihmon në:

1. Promovimin mbi shërbimet, programet, zyrat, ofruesit, kualifikimet, programet e punësimit dhe ofertat e AFP-së;
2. Ndërtimi i imazhit publik të Agjencisë dhe promovimin e tij;
3. Ngritjen dhe funksionimin e komunikimit të Brendshëm institucional;
4. Ngritjen dhe funksionimin e komunikimit të Jashtëm ndër-institucional;
5. Ngritjen dhe funksionimin e komunikimit të Brendshëm institucional;
6. Ndërtimin e planit të bashkëpunimit me Punëdhënësin;
7. Monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të realizuara në kuadër të rritjes së vizibilitetit të Agjencisë.

Panairi i Punës

Gjatë vitit 2021, Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, organizoi për herë të parë Panairin Virtual të Punës dhe Aftësive 2021, me mbështetjen e Programit Global “Migracion për Zhvillim”, i cili zbatohet nga GIZ. Risia kryesore që solli ky panair virtual ishte fakti që vendet e punës (për punëkërkuuesit) dhe ofertat potenciale për punë (nga bizneset) me aftësitë specifike të kërkuara ndërvepronin në mënyrë direkte nëpërmjet platformës online. Pjesëmarrësit në panair i përkisnin institucioneve arsimore si dhe punëdhënësve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, të cilët ofruan: mundësi punësimi, mundësi për praktikë profesionale, mundësi për bursa të ndryshme studimi, orientim dhe këshillim në karrierë.

Publikimi i Vendeve të Lira të Punës

Gjatë vitit 2021 janë shpallur 2152 kërkesa për publikim të vendeve të lira të punës së Administratës Publike.

Rastet e suksesit, promovimi i tyre dhe përgatitja e materialeve të tjera promovuese

AKPA, sa i përket angazhimit në fushatat promovuese, ka në fokus evidentimin dhe promovimin e rasteve të suksesit të punëkërkuësve të papunë që integrohen në tregun e punës përmes procesit të ndërmjetësimit që administrohet nga Zyrat e Punës. Gjithashtu, në kuadër promovimit të rëndësisë dhe mundësive të ofruara nga sistemi i AFP-së, janë publikuar në mënyrë të vazhdueshme raste suksesi ose dëshmi personale nga nxënës në Arsim Profesional, ose kursant në Formim Profesional.

Gjatë vitit 2021, me qëllim informimin e publikut dhe rritjen e imazhit të AFP-së, janë zhvilluar aktivitetet sa më poshtë vijon:

1. Realizimi i videove promovuese për shkollat e mesme profesionale në kuadër të fillimit të vitit të ri shkollor.
2. Bashkëpunimi me koordinatorët për zhvillimin e Marketingut në Shkollat e Mesme


Profesionale dhe Qendrat e Formimit Profesional Publik në vend dhe specialistët e Zyrave të Punës me qëllim informimin dhe promovimin e shërbimeve të ofruara nga AKPA.

3. Promovimi i 112 rasteve të suksesshme të nxënësve që studiojnë në shkollat profesionale.
4. Realizimi i 30 videove për promovimin e rasteve të suksesit të ndërmjetësuar nga ana e Zyrave të Punës apo punësuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.


Menaxhimi i Sistemit të Kërkesave për Informacion dhe i Ankesave në AKPA

Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ka vendosur në dispozicion të qytetarëve disa kanale komunikimi përmes të cilave mund të informojë dhe adresojë të gjitha kërkesat dhe ankesat në fushën e punësimit dhe aftësisimit profesional. Për vitin 2021 numri total i ankesave/kërkesave të ardhura nga kanale të ndryshme komunikimi për periudhën janar – dhjetor 2021 është 1618 total dhe shpërndarja e tyre është si më poshtë vijon:

- Platforma e Bashkëqeverisjes- rreth 16%
- Adresa e kontaktit- rreth 70%
- Rrjete Sociale (facebook)- rreth 9%
- vendetelinpune.shkp- rreth 3%
- Te tjera (numër telefoni, email personal i drejtuesve, fizikisht, MFE)- rreth 2%



Grafiku nr. 2. Ankesat sipas kanaleve të komunikimit



Grafiku nr. 3. Kërkesat/Ankesat nga adresa e kontaktit



KAPITULLI VIII

LIDHJET ME PROJEKTE, PROGRAME DHE PARTNERË STRATEGJIKË

INSTRUMENT FOR PRE-ACCESSION ASSISTANCE (IPA II)- Asistenca Teknike për të Mbështetur Reformën në Politikat e Punësimit dhe Arsimit dhe Aftësimin Profesional

AKPA është një ndër institucionet përfituese të projektit të Asistencës Teknike për të Mbështetur Reformën në Politikat e Punësimit dhe Arsimit dhe Aftësimin Profesional. Objektivi i përgjithshëm i kësaj asistence është të kontribuojë në zbatimin e planit të veprimit NESS 2019 - 2022 përmes ngritjes së kapaciteteve dhe zhvillimit institucional në punësimin dhe shërbimet e AFP-së. Projekti është hartuar në dy komponentë:

- **Komponenti 1**, për të forcuar shërbimet e punësimit përmes një Modeli të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, hartimit të një Plani Kombëtar të Garancisë së të Rinjve dhe një Strategjie Komunikimi për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA). Në lidhje me këtë komponent janë realizuar produktet e mëposhtme deri më tani:
 - Raporti mbi Analizën e praktikave të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të AKPA-s, analizë përmes së cilës është propozuar një kornizë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për AKPA-n Qendrore dhe Zyrat e Punësimit dhe mbi mënyrën e ardhshme të funksionimit dhe organizimit.
 - Paketa e trajnimit për Trajnimin e Trajnerëve, dokument i cili synon të prezantojë modelin e Trajnimit të Trajnerëve (ToT), Paketën e Trajnimit për ToT, kurrikulat e kurseve brenda kësaj pakete, udhëzimet për zbatimin e tij dhe të shërbejnë si model apo bazë për zhvillimin e kurrikulave të kurseve dhe paketave të tjera të trajnimit.
 - Rekomandime për Përzgjedhjen e Trajnerëve të Brendshëm dhe formularin e aplikimit për ToT.
 - Raporti i Analizës së Nevojave për Trajnim (TNA) dhe instrumentet e zhvilluara për këtë qëllim, si dhe një sërë rekomandimesh për hapa të mëtejshëm për zhvillimin dhe menaxhimin e mëtejshëm të burimeve njerëzore brenda AKPA-s.
 - Studimi bazë “Mapping and profiling of Young Neets in Albania” me qëllim kryesor ofrimin e një pasyrimi të karakteristikave dhe profilizimit të kategorisë NEET në Shqipëri me qëllim të identifikimit të prioritetëve strategjike dhe propozimeve të veprimeve që do përfshihen në Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore.
 - Strategjia e re e Komunikimit me qëllim promovimin mbi shërbimet e ofruara nga AKPA dhe forcimin e sistemit të brendshëm të komunikimit.
- **Komponenti 2**, përmes një Modeli të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për sektorin e AFP-së, një plani kombëtar të zhvillimit të ofruesit të AFP-së dhe një plani të përgjithshëm të investimeve, dhe dizajnit të një MIS-i të AFP-së.

Në këtë drejtim, është realizuar analiza e situatës ligjore mbi të cilën bazohet funksionimi i Ofruesve të AFP-, Raporti mbi specifikimin e kërkesave për Sistemin e Menaxhimit të Informacionit të AFP-së (VET-MIS), si dhe Analiza e thelluar e situatës fillestare/ bazë të të gjitha sistemeve informatike për menaxhimin e informacionit të AFP-së, që kanë qenë në zbatim gjatë kohës së kryerjes së analizës.



Mbështetje për Mësimin e Vazhduar të të Papunëve” (SCUL)

Projekti “Mbështetje për Mësimin e Vazhduar të të Papunëve” (SCUL) është financuar nga **Programi EaSI** i Bashkimit Evropian dhe po zbatohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive në partneritet me UNDP Albania. Objektivat kryesore të projektit janë zhvillimi i aftësive bazike mësimore dhe digjitale të punëkërkesve të papunë me kualifikim dhe edukim të ulët (lexim dhe shkrim), me qëllim që në vijim të mund të integrohen në tregun e punës. Sa i përket zbatimit të paketave të projektit, janë realizuar produktet:

- Analiza cilësore dhe sasiore të target grupit duke rezultuar në një raport final të detajuar të punëkërkesve të papunë afat-gjatë të regjistruar në Shqipëri.
- Përshtatja e instrumentit të ndërtuar nga UNESCO Life-Long Learning.
- Realizimi i studimit të fizibilitetit për metodologjisë së vlerësimit të target grupit.

Është parshikuar ndërtimi i një VKM-je për zbatimin e programit dhe ka filluar puna për instrumentat e nevojshëm për zbatimin e tij gjatë vitit 2022.



S4J “Skills for Jobs”

Është finalizuar marrëveshja e bashkëpunimit mes Qendres “Shkolla e Drejtorëve të Institucionit të Arsimit Parauniversitar” (CSL), Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) dhe Projektit të Agjencisë Zviceriane për Zhvillim e Bashkëpunim, zbatuar nga Sëisscontact, “Aftësi për Punë (S4J), nënshkruar në Dhjetor të vitit 2021, e cila konsiston në trajnimin e detyrueshëm përgatitor për drejtuesit e institucioneve të arsimit parauniversitar ku përfshihen dhe drejtuesit e institucioneve të Arsimit e Formimit Profesional, përmes një sistemi të unifikuar. Në kuadër të kësaj marrëveshje po hartohet kurrikula e përshtatur për ofrimin e këtij kualifikimi për drejtuesit e shkollave të mesme profesionale. Gjithashtu është kryer Vlerësimi dhe rishikimi i sistemit informatik të DROFPP-ve, e mbështetur nga S4J.

Gjithashtu ky projekt ka bashkëpunuar me AKPA për realizimin e procesit të gjurmimit të diplomuarve dhe certifikuarve të AFP.



GFA PROSEED

Projekti “Mbështetje për Qendrat e Formimit Profesional Publik”, pjesë e Programit të GIZ “Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik dhe rajonal, promovimi i punësimit, arsimit dhe formimit profesional në Shqipëri”, ProSEED, i cili zbatohet nga GFA Consulting Group. Me qëllim rritjen e cilësisë së programeve të ofruara, si në shërbim ashtu dhe në kurrikul, u arrit: 1. Llogaritja e kostove për kurset profesionale nga Qendrat e Formimit Profesional. U vunë në dispozicion formatet në

excel të hartuara nga Përfaqësues të GFA Consulting Group/GIZ-ProSeed dhe të gjitha Qendrat e Formimit llogariten koston për kurset profesionale që zhvillojnë; 2. Është kryer procesi i monitorimit/vlerësimit të subjekteve private të licencuara për "Formim Profesional" në Kodin X.2.B nga viti 2009 deri në 2021, në shkallë vendi. Metodologjia e monitorimit u hartua duke patur në fokus elementë të monitorimit përshkruar në bazën ekzistuese ligjore me elementë të monitorimit aplikuar nga GIZ-ProSEED për ofruesit privatë gjatë periudhës 2019-2020.

Gjithashtu nëpërmjet këtij projekti është ndërtuar kurrikula e re digjitale "Aftësi digjitale", e cila trajton 5 kompetencat bazë digjitale sipas EU Digital Competencies Framework 2.0., që është konceptuar për t'i shërbyer edhe punëkërkuarve të papunë.

MARRËVESHJE MOBILITETI PËR PUNË ME KOSOVËN

Në fund të vitit 2020, u nënshkrua marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike e Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë së Republikës së Shqipërisë. Marrëveshja fokusohet mbi çështjet e punësimit dhe aftësimit profesional bazuar mbi orientimet e BE-së, zotimet që dalin nga procesi i Berlinit, bashkëveprimi ndërkufitar në kuadër të përafrimit të masave në lidhje me mobilitetin për punë dhe politikave të përbashkëta dhe forcimin marrëdhëniesve mes agjencive zbatuese të politikave të punësimit dhe aftësimit profesional. Në këtë kuadër, në muajin Tetor të vitit 2021 është zhvilluar workshop-i i parë ndërmjet dy agjencive të punësimit ku, ndër të tjera, parashikohet bashkëpunim në përmirësimin e kuadrit rregullator respektiv mbi të huarjt, me qëllim lëvizjen pa procedura apo me procedura të lehtësuara ndërmjet dy vendeve, shkëmbime të paketave ekzistuese informative, si dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të dy vendeve përkatëse mbi procedurat dhe paketat e ofrimit të shërbimeve.



DIMAK- PROGRAMI GLOBAL MIGRIM PËR ZHVILLIM (PME)

Qendra Gjermane e Informacionit për Migracion, Arsim Profesional dhe Karrierë (DIMAK Albania) është pjesë e Programit Global "Migrim për Zhvillim" (PME), i cili zbatohet në Shqipëri nga Qendra Ndërkombëtare për Migrim dhe Zhvillim, një bashkëpunim i Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH dhe Zyrës së Agjencisë Federale për Punësim (BA). Objektivat kryesore të projektit janë: a) rritja e kapaciteteve në këshillimin e punësimit jashtë vendit për AKPA; b) këshillimi për arsim profesional dhe punësim në Shqipëri; c) informacion mbi risqet e migrimit të jashtëligjshëm dhe këshillim mbi migrimin e rregullt; d) këshillim në kthim dhe riintegrimi.



RISI ALBANIA

Projekti ka në fokus kryesor marrëdhëniet bilaterale të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe Bizneseve (Punëdhënësve) me qëllim ndërtimin dhe rregullimin e metodologjisë së qasjes ndaj këtyre të fundit. Në këtë kuadër, Risi

Albania, në kuadër të këtij projekti ka zhvilluar Udhëzuesin e AKPA për Ndërtimin dhe Zhvillimin e Marrëdhënieve të Bashkëpunimit me Punëdhënësin dhe Analizën e Tregut Rajonal të punës, Metodologjinë për Sistemin e Menaxhimit dhe Monitorimit të Kënaqësisë Qytetare për AKPA, Sistemit të Menaxhimit të Ankesave, si dhe sipas komponentit të forcimit të ofrimit të shërbimeve të udhëzimeve të karrierës si dhe të ndërmjetësimit.



UNDP- UNITED NATIONS DEVELOPMENT PROGRAMME, Albania

UNDP, si një prej partnerëve kryesorë, vijon të mbështesë aktivitetin e AKPA-s duke asistuar Agjencinë në një sërë iniciativash si:

- Ndërtimi i manualit të punëdhënësit, si pjesë e Programit të Punëve Publike në Komunitet në zbatim të VKM-së Nr. 535, 8.7.2020 “Procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e Programit të Punëve në Komunitet”
- Realizimi i trajnimeve përkatëse të të gjithave Zyrave të Punësimit për zbatimin e kësaj VKM-je.
- Realizimi i trajnimeve me punëdhënësit (OJF, njësi bashkiake, partnerë socialë, ndërmarrje shtetërore etj.) që përfitojnë nga Programi i Punëve Publike në Komunitet.
- Janë realizuar trajnimet e Zyrave të Punësimit për zbatimin e VKM Nr. 348, datë 29.4.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”.



GIZ- PROJEKTI “FONDI PËR AAP DHE PUNËSIMIN - MFC KAMZA”

Qeveria Gjermane është angazhuar në mbështetjen e Qeverisë së Shqipërisë për përmirësimin e mëtejshëm të arsimit dhe aftësisht profesional në Shqipëri, posaçërisht duke mbështetur krijimin e Qendrës Multifunkionale të Trajnimit (QMT) në Kamzë si një pilot për zgjerimin e mëtejshëm të QMT të synuar rrjeti në Shqipëri. Projekti “Fondi për AAP dhe Punësimin - QMT Kamza” është konkluduar me sukses, ndërtuar një model të ri ofruesi të AFP-së, dhe duke kombinuar disa elementë të sistemit të dyfishtë si arsimit profesional me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme me theks të veçantë në trajnimin praktik në kompani private që do t'i bëjë studentët më të përgatitur për tregun e punës. QMT ofron gjithashtu kurse trajnimi profesional afatshkurtër të përshtatura për një gamë të gjerë grupesh dhe moshash të synuara duke përfshirë studentë, punëkërkues të papunë, grupe të pafavorizuara dhe trajnime teknike sipas kërkesave të veçanta nga biznesi.



REGIONAL CHALLENGE FUND

Programi i mbështetjes së grantit RCF ka për qëllim të forcojë trajnimin bashkëpunues dhe në këtë mënyrë të rrisë cilësinë dhe rëndësinë e punësimit të masave të trajnimit profesional. Për këtë qëllim, RCF mbështet krijimin e konsor-

ciumeve ndërmjet instituteve të trajnimit profesional dhe sipërmarrjeve për implementimin e programeve të trajnimit bashkëpunues përmes Memorandumit të Mirëkuptimit. Për t'u pranuar, partnerët e projektit duhet të jenë të përgatitur të përfshihen në aktivitete të përbashkëta trajnuese me qëllim kualifikimin e kursantëve duke u bazuar në kualifikimet dhe/ose standardet e punës që korrespondojnë me kërkesën e tregut të punës.

Gjatë vitit 2021, përmes thirrjes së parë të projektit që financohet nga RCF, kanë rezultuar fituese Shkollat e Arsimit Profesional dhe Drejtoritë e Ofrimit të Formimit Profesional Publik, si më poshtë:

- Shkolla e Mesme Profesionale “Kristo Isak” , Berat
- Shkolla Teknike Elektrike “Gjengji Canco”, Tiranë
- Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik, Vlorë
- Shkolla “Sali Ceka”, Elbasan

Për sa më lart, ofruesit e AFP-së priten të zbatojnë projektet e tyre në vitet pasardhëse.

**ANALIZA VJETORE
E AGJENCISË KOMBËTARE TË
PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

MBI ECURINË E AKTIVITETEVE PËR VITIN 2021

(A): Blv. "Bajram Curri", 1004, Tiranë, Shqipëri

(E): kontakt@akpa.gov.al | (W): www.puna.gov.al

(T): +355 44538827